



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



Monitorimi i Investimeve Kapitale të KRU “Gjakova” sh.a Gjakovë – Viti 2022

Zbatimi i listës së projekteve të investimeve kapitale të aprovuara gjatë procesit
tarifor 2022-2024 për vitin 2022

Prishtinë, gusht 2023

Përmbajtja

1. Hyrje.....	3
2. Investimet e aprovuara për KRU Gjakova	4
3. Investimet e realizuara nga KRU-të sipas procesit të auditimit të të dhënave.....	4
4. Monitorimi i listës së investimeve kapitale	6
5. Konkluzione	10
6. Rekomandime.....	10

1. Hyrje

Me qëllim të monitorimit të investimeve kapitale të aprovuara gjatë procesit tarifor 2022-2024, komfor mandatit ligjor, ARRU ka realizuar takime në të gjitha KRU-të, për të vlerësuar nivelin e zbatimit të projekteve për vitin 2022.

Takimet janë realizuar ndaras me secilën KRU, përkatësisht takimet janë mbajtur me zyrtar të Departamentit Teknik dhe të Departamentit të Financave të KRU-ve, për të diskutuar listën e projekteve të aprovuara me procesin tarifor dhe nivelin e zbatimit të projekteve për vitin 2022.

Monitorimi i zbatimit të investimeve kapitale nga Departamenti i Tarifave të ARRU është e ndërlidhur edhe me auditimin e të dhënave që ka bërë paraprakisht Departamenti i Performancës. Si vlera të besueshme të investimeve të realizuara janë marrë të dhënat nga procesi i auditimit të të dhënave, të shpërndara sipas kategorive të Udhëzuesit të Kontabilitetit Rregullator.

Më datë 24.05.2023, është mbajtur takimi në zyrat e KRU “Gjakova”, ku të pranishëm nga ana e ARRU-së, ishin:

Refik Ramaj	Udhëheqës i departamentit të tarifave.
Hysni Feka	Analist për tarifa
Vehbi Duraku	Analist për asete dhe investime kapitale.

Nga KRU Prishtina në këtë takim ishin:

Visar Hasi	Drejtor Teknik
Sihana Asllani	Menaxhere Financiare
Shkodran Gaxherri	Specialist për zbatimin e projekteve

Ky raport merr për bazë të dhënat e realizuara nga KRU për vitin 2022 në bazë të shënimeve të marra gjatë procesit të auditimit të të dhënave si dhe krahason të dhënat e projekteve të investimeve kapitale, sipas BPRR, duke vlerësuar statusin e realizimit të tyre në bazë të të dhënave të marra gjatë takimit dhe dokumenteve përcjellëse të dërguara nga KRU-të përmes e-mailit.

2. Investimet e aprovuara për KRU Gjakova

Procesi tarifor (2022-2024), bartës i të cilit është ARRU, ka një komponentë tejet të rëndësishme që janë investimet kapitale që KRU-të planifikojnë t’i realizojnë gjatë periudhës tre vjeçare. Lista e investimeve kapitale pastaj shpërndahet në kategori të caktuara sipas Udhëzuesit të Kontabilitetit Rregullator dhe si e tillë ka ndikim të drejtpërdrejtë në lartësinë e tarifës, rrjedhimisht edhe në të ardhurat e KRU.

ARRU ka pranuar Listën e Investimeve Kapitale të realizuara nga KRU. Duke qenë se Plani i Menaxhimit të Aseteve nuk është finalizuar ende nga KRU, për të arsyetuar këtë listë të investimeve, KRU sipas udhëzimeve të ARRU, për secilin projekt të propozuar ka përgatitur një arsyetim, pjesën përshkruese si dhe para masën dhe para llogarinë për projektet e listuara.

Pas pranimit të aplikacionit tarifor, ARRU mbështetur në parimet bazë për përballeshmërinë e faturës nga ana e konsumatorit dhe për të ruajtur nivelin e shërbimit të KRU-së, ka bërë ndërhyrje në vlerat e projekteve të investimeve kapitale prej burimeve vetjake. Këto ndërhyrje në tekstin e më poshtëm përkufizohen me shprehjen “Rregullimet nga ARRU”. Në disa raste janë shtuar vlera të investimeve kurse në raste tjera janë zbritur vlera të investimeve.

Këto rregullime u janë dërguar KRU-së të cilës u është kërkuar që të dërgojnë e listën e azhurnuar komfor ndërhyrjeve nga ARRU. Listën e azhurnuara KRU-ja nuk e ka dërguar në ARRU, e cila gjë e ka vështirësuar analizën e realizimit të investimeve sipas projekteve.

3. Investimet e realizuara nga KRU-të sipas procesit të auditimit të të dhënave

Ekipi i ARRU-së për auditimin e të dhënave, pas takimit të mbajtur në KRU, ka marrë të dhënat e realizuara të investimeve kapitale nga moduli i kontabilitetit. Ato investime të cilat kanë qenë të regjistruara në modul të kontabilitetit, të cilat, njëherësh, plotësojnë kriteret për t’u regjistruar në kontabilitet, janë njohur nga ARRU si investime të realizuara për periudhën përkatëse, në këtë rast për vitin 2022.

Për nevoja të krahasimit, në tabelën vijuese do të paraqiten shumat e investimeve kapitale, të ndara sipas kategorive, ku do të jenë investimet e aprovuara nga ARRU dhe pastaj shumat e realizuara nga KRU. Realizimi i investimeve të planifikuara është bërë ndaras për investimet e financuara nga KRU dhe ndaras për investimet e financuara nga grantet (Donacionet).

Tabela 1. Investimet në shërbimet e ujësjellësit

Kategoria e investimeve kapitale			Vlera e planifikuar		Vlera e realizuar	
			Financuar nga KRU	Grantet	Financuar nga KRU	Grantet
Resurse dhe trajtim	Infrastrukturë	Përteritje				
		Rritje			20,852.0	65,526.0
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	53,000.0	0.0		
		Rritje	43,000.0	100,000.0		
Distribuem	Infrastrukturë	Përteritje	233,592.0	7,069,570.0	173,132.0	1,411.0
		Rritje	171,400.0	1,921,797.0	253,929.0	26,070.0
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	189,000.0	444,326.0	6,320.0	0.0
		Rritje	50,197.0	0.0	93,304.0	11,561.0
Aktivitet Biznesor	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje				
		Rritje	247,850.0	0.0	53,313.0	428.0
Totali			988,039.0	9,535,693.0	600,850.0	104,996.0

Tabela 2. Investimet në shërbimet e ujërave të ndotura

Kategoria e investimeve kapitale			Vlera e planifikuar		Vlera e realizuar	
			Financuar nga KRU	Grante	Financuar nga KRU	Grante
Grumbullim	Infrastrukturë	Përteritje	134,000.0			
		Rritje		2,000,000.0		
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje				
		Rritje				
Trajtim ujërave ndotura	Infrastrukturë	Përteritje				
		Rritje				
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje				
		Rritje				
Trajtim i Llumit	Infrastrukturë	Përteritje				
		Rritje				
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje				
		Rritje				
Aktivitet Biznesor	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje				
		Rritje	65,389.0	130,000.0	2,806.0	23.0
Totali			199,389.0	2,130,000.0	2,806.0	23.0




Figura 1. Grafiku i krahasimit të realizimit të investimeve të financuara nga KRU dhe nga Grantet

Prej burimeve të financimit nga KRU, në total KRU-ja ka planifikuar 1,187,428 € prej të cilave ka realizuar 603,656 €, apo shprehur në përqindje ka realizuar 50.8% të investimeve.

Prej burimeve të financimit nga grantet, KRU, ka planifikuar 11,665,693€, prej të cilave i ka realizuar 105,019 €, apo shprehur në përqindje ka realizuar 0.9% të investimeve.

Meqë investimet e realizuara nga tarifa janë synim i monitorimit të ARRU-së, monitorimi i investimeve në këtë proces nuk ka marrë për bazë projektet një nga një nga grantet.

4. Monitorimi i listës së investimeve kapitale

Monitorimi i Listës së Investimeve Kapitale konsiston në verifikimin e projekteve të dorëzuara nga KRU sipas Listës, e cila si e tillë, përveç emrit të projektit ka edhe dokumentin mbështetës me përshkrim, arsyetim, para masë dhe para llogari të projektit të caktuar.

Ekipi nga ARRU ka diskutuar dhe vlerësuar implementimin e projekteve sipas Listës së investimeve me përfaqësuesit e KRU, prej nga ka marrë informacione rreth statusit aktual për secilin projekt.

Në tabelën 3 dhe 4 janë paraqitur ndaras lista e projekteve për shërbimeve të ujit nga ato për shërbimet e ujërave të ndotura. Në kolonën e fundit janë komentet e ARRU-se, të marra gjatë takimit, mbi gjendjen në të cilën ndodhet secili projekt.

LISTA E PROJEKTEVE TË INVESTIMEVE KAPITALE DHE STATUSI I REALIZIMIT TË TYRE

Tabela 3. Statusi i projekteve në shërbimet e ujësjellësit të financuara nga KRU

Nr	Projektet Sipas kategorive	Aprovuara nga ARRU	Realizuara nga KRU	Statusi i projektit
a	Përtëritja e infrastrukturës			
1	Furnizimi -Mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijes për të gjitha njësitë me pjesë më të mëdha se 2"(coll) dhe më të vogla se 2"(coll). Këtu hyjnë edhe Ujëmatësit e dimensioneve të mëdha dhe gypat për ndërrimin e rrjetit nëpër rrugët të cilat do të asfaltohen.	400,000	248,000	Eshët shpall tenderi, është ekzekutuar. Një pjesë e konsiderueshme është furnizuar
2	Ndërrimi i gypit në fshatin Ramajë L=1700m, gypa nga Ø63 -110 /10 bar.	15,300	0	Nuk është ekzekutuar. Nuk ka mundur KRU ta përballojë, për shkaqe financiare.
3	Ndërrimi i rrjetës shpërndarëse në fshatin Krusha e Madhe ne drejtim te Drini i Bardhë L= 900m, gypa nga Ø63 -75 /16 bar.	7,650	n/a	Janë bere investime tjera ne Rahovec dhe në zona tjera të KRU-së.
4	Rehabilitimi i furnizimit me ujë i fshatit Bratotin	5,100		Nuk është realizuar ky projekt, ka mundësi qe ne këtë vit te fillojnë procedurat.
5	Ndërrimi i gypit ne Rahovec Rr. UÇK , L= 770 m, Ø125	10,200	101,256	Janë bere investime tjera ne Rahovec dhe në zona tjera të KRU-së.
6	Ndërrimi i gypit në Rahovec Rr,Tafil Zyberaj L=800 m Ø90	6,120		Janë bere investime tjera ne Rahovec dhe në zona tjera të KRU-së.
7	Ndërrimi i Gypit ne Rahovec Rr. Bekim Isma L= 300m Ø100	5,100		Janë bere investime tjera ne Rahovec dhe në zona tjera të KRU-së.
8	Ndërrimi i gypit në Rahovec Rr. Ali Sokoli L=365 m Ø160 dhe Ø90	9,180		Janë bere investime tjera ne Rahovec dhe në zona tjera të KRU-së.
9	Ndërrimi i gypit AC ne Rr. Mizaim Isma L=300m	15,300		Janë bere investime tjera ne Rahovec dhe në zona tjera të KRU-së.
10	Rregullimet nga ARRU	-240,358		
B	Rritja e infrastrukturës			
1	Ndërtimi i rrjetit te ujesjellesit ne Reken e Keqe	0		
2	Ndërtimi i trases së ujësjellësit për ujë të pijes, Rakita-ETC-Xerxe L=2.660 m	45,900	0	Është hequr ky projekt. është bashkëfinancim. Nuk ka pas interesim nga Komuna. Nuk ka lëvizje deri me tani.
3	Ndërtimi i ujësjellësit ne lagjen e Firzës për 42 shtëpi	25,500	53,000	Është realizuar, vlera është rreth 53,000 €.
4	Projekti për furnizim me ujë i fshatit Damjan nga liqeni i Radoniqit	100,000	0	Nuk është realizuar, njëjtë me rastin e Greqines.
C	Mirëmbajtja e jo-infrastrukturës			
1	2 copë, Bombola te klorit të gaztë 1/1000, material prej qeliku me vëllim V=0.8 m3, PI=22bar (shtypja e testimit, PN=22 bar (shtypja punuese) ngjyra sipas standardeve te BE-se (e verdhë)	16,000	0	Është shpall tenderi dhe i njëjti ka dështuar qe te realizohet nga operatorët. Si pasoje e ankesave brenda operatorëve dhe pastaj është anuluar nga OSHP.
2	2 copë, Bombola te klorit te gaztë V=150 kg, material prej qeliku me vëllim V=150l, ose 0.12 m3, PI=22bar (shtypja e testimit, PN=22 bar (shtypja punuese) ngjyra sipas standardeve te BE-se (e verdhë)	2,000	0	Është shpall tenderi dhe i njëjti ka dështuar qe te realizohet nga operatorët. Si pasoje e ankesave brenda operatorëve dhe pastaj është anuluar nga OSHP.
3	Furnizim me material Laboratorik, fiziko-kimik dhe bakteriologjik për nevojat e KRU Gjakova	20,000	20,000	është kontratë kornizë dhe realizohet çdo vit. është duke u realizuar projekti.
4	Inventar Laboratorik	8,000	0	Ka dështuar në 2022 është rishpall në 2023.
5	Servisimi i aparatures se Karbonit Aktiv	5,000	0	Nuk është realizuar për arsye se ka pas prioritet projektet tjera, dhe pajisja vazhdonte te funksiononte pas sanimit te operatives.
6	Izolimi i rezervarit të kthines ndarëse te Stacioni i filtrave	2,000	0	Nuk është realizuar. është llogarit qe nuk ka investim te tille për momentin.

7	Furnizim me material elektrik për nevojat e mirëmbajtjes elektrike (ndiqimi per objekte, ormanet elektrik, rele niveli, kablot, ndërpreres automatik,	10,000	10,000	Është kontratë kornize. Ne 2022 janë kry procedurat e tenderimit. Po vazhdon projekti.
8	Furnizim dhe montimi me material elektro energjetik (tensioni i lartë) për tere sistemin (Trafot, largpërçuesit, kablot 10 Kv etj)	50,000	0	Nuk është realizuar. Do te shikohet bashke me KEDS-in me analizuar këtë projekt.
9	Mirembajtja e linjes 35 Kv, 10kV,trafo energjetik 35/10/0.4kV	20,000	20,000	është realizuar ne 2022.
10	Furnizim me motorr pompa te reja me specifika te ndryshme per zevendesimin e pompave te vjetra P=prej 2.2 kw deri 132 Kw, me sofstarterat dhe hidrokontroller	40,000	0	Nuk është realizuar. Mendohet se edhe ne 2023 nuk do te realizohet, për shkaqe financiare te KRU-se.
11	Servisimi i pompave dhe rimbështellja e motorëve te KRU"Gjakova"	9,000	9,000	Është kontratë kornize. Ne 2021 janë kryer procedurat e tenderimit. Po vazhdon projekti.
12	Mirëmbajtja e rrugës nga Rezervari Batushë deri te kaptazha (vepra marrëse) L=8000 m, dhe rregullimi i vepres marrese te burimi i ujit	60,000	0	Është shpall tenderi ne 2022, ka shkuar lënda ne OSHP pastaj është anuluar. KRU-ja me fuqi motorike vetanake dhe punëtorët e kanë mirëmbajt vet.
d	Rritja e jo-infrastrukturës			
1	Rrethimi i Liqenit të Radoniqit dhe kanalit derivues (sipas zonave mbrojtëse) L= 12.700 m	25,000	0	Nuk është realizuar, tash është heq krejt.
2	Furnizim me 2 kaldaja për St. Filtrave	18,000	1,800	është realizuar ky projekt me vlere prej 1,800 euro. Kurse ne BPRR paska qene lëshim teknik, është vendos një 0 me tepër ne BPRR.
3	Ndërtimi i Stacionit të pompave shtytese për fshatin Morinë	20,197	0	Nuk është realizuar. Për shkak te planifikimit buxhetor. Ne 2023 do te rishpallet me bashkëfinancim.
4	Furnizim me instrumente per detektime te thella te humbjeve te ujit Radar detektues sipas specifikave	30,000	0	Nuk është realizuar. Për shkak te planifikimeve financiare si pasoje e dënimit qe ka KRU-ja ndaj ATK-se.
e	Aktivite biznese			
1	Furnizimi me pajisje te TI per te gjitha njësit	30,451	30,451	Është realizuar. Ne fund te vitit 2022.
2	Furnizim me makineri- 1 skip i madh 75 kw - 102 kw, nje kamionet e vogel, 2 gjipa , Furgon me mjete te punes percjellëse per defekte.	95,000	30,644	Është blere vetëm SKIPI. Ato tjerat për shkak te buxhetit te limituar. Edhe rritja e çmimeve ka ndikuar për furnizime me te vogla.
3	Furnizimi i punëtorëve me mjete pune për të gjitha njësitë.	19,000	0	Ne 2022 nuk janë shpall ne 2022, do te shpallet ne 2023.
4	Softweri ERP me SCADA	300,000	79,150	Është shpall pjesërisht ne 2022. ka pas ankese dhe është nënshkruar kontrata ne fund te vitit 2022. Vlora është 79,150 euro. Për momentin vetëm handhold unit, faturimi mobil.
5	Investime te marra nga shtojca e projekteve 2022-2024, jo-infrastruktura, nr.rendor I projekteve 17,20,21,22,24,25,26,27,28,29,30,31,32(95% Uje)	-226,601	n/a	n/a

Tabela 4. Statusi i projekteve në shërbimet e ujërave të ndotura të financuara nga KRU

Nr	Projektet Sipas kategorive	Aprovuara nga ARRU	Realizuara nga KRU	Statusi i projektit
a	Përtëritja e infrastrukturës			
1	Investime ne kapaket e pusetave per kanalizim	4,000	0	KRU-ja ka ndertuar vet kapakët nga betoni dhe për këtë nuk ka shpall tender.
2	Montimi dhe sigurimi i kapakëve për puseta te kanalizimit fekal	40,000	0	Nuk është shpall tender, pasi qe disa prej tyre merren nga furnitori XERXA qe është me një projekt të ujësjellësit.
3	Riparimi i kanalizimit fekal Gjakovë dhe Rahovec	20,000	0	Nuk është shpall tender, por janë marre nga "Xerxa" qe lidhet me projekt të ujësjellësit.
4	Ndërrimi i gypave të kanalizimit-Gjakovë	10,000	0	Nuk është shpall tender, por janë marre nga "Xerxa" qe lidhet me projekt të ujësjellësit.
5	Ndërrimi i gypave të kanalizimit – Rahovec	10,000	0	Nuk është shpall tender, por janë marre nga "Xerxa" qe lidhet me projekt të ujësjellësit.
6	Rregullimet nga ARRU	50,000	0	KRU-ja nuk ka investuar.
b	Rritja e infrastrukturës			
1				
2				
C	Mirëmbajtja e jo-infrastrukturës			
1				
2				
C	Rritja e jo-infrastrukturës			
1				
2				
3				
d	Aktivitete biznesore			
1	Blerja e pajisjeve për operim dhe mirëmbajtje për dy Njësit	15,000	0	Nuk është investuar.
2	Furnizimi me pjesët rezervë (harxhuese) për dy cisternat e kanalizimit	10,000	0	Nuk është investuar
3	Furnizim me mjete pune për mirëmbajtjen e kanalizimit sipas standardeve	10,000	2,806	Janë blere 4 maska. Rreth 800 euro një maske.
4	Investime te marra nga shtojca e projekteve 2022-2024, jo-infrastruktura, nr.rendor I projekteve 17,20,21,22,24,25,26,27,28,29,30,31,32 (5% kanalizim)	14,389	n/a	n/a
5	Furnizim me gyp të gomës me shtypje të lartë për Cisternë të kanalizimit (2 copë)	10,000	0	Nuk është bere furnizimi akoma, është në dosje te tenderit për mirëmbajtjen e projekteve.
8	Furnizim me makineri- 1 skip i madh 75 kw - 102 kw, nje kamionet e vogel, 2 gjipa , Furgon me mjete te punes percjellëse per defekte.	5,000		Është projekt i përbashkët me shërbimet e ujësjellësit.
9	Furnizimi i punëtorëve me vegla pune për të gjitha njësitë.	1,000	0	Nuk është realizuar

5. Konkluzione

1. Prej burimeve të financimit nga KRU, në total KRU ka planifikuar 1,187,428 € prej të cilave ka realizuar 603,656 €, apo shprehur në përqindje ka realizuar 50.8% të investimeve.
2. Prej burimeve të financimit nga grantet, KRU, ka planifikuar 11,665,693€, prej të cilave i ka realizuar 105,019 €, apo shprehur në përqindje ka realizuar 0.9% të investimeve.
3. Emërtimi i projekteve në Biznes Plan Rregullatorë ka qenë i përgjithësuar e cila e bën të vështirë të përcillet projekti i tillë që është i shpërndarë në disa pozicione.
4. Projektet, të cilat, për shkaqe të ndryshme, nuk janë pranuar teknikisht, sipas 'Udhëzimeve të Kontabilitetit Rregullator', nuk mund të evidentohen në regjistrat kontabël. Kjo është arsyeja, që këto investime, të njohura si 'Investime në Vijim', nuk janë të përfshira, si të realizuara, gjë që, ul përqindjen e realizimit të investimeve kapitale nga burimet vetjake.
5. Në kategorinë e investimeve në infrastrukturën e ujërave të ndotura, me mjetet vetjake të financimit, KRU nuk ka bërë investime sipas planifikimeve.
6. Mos realizimi i investimeve kapitale ishte ndikuar nga vonesat në procedurat e prokurimit, problemet financiare, ndërrimeve në menaxhmentin e KRU-së etj.
7. Për shkak të mungesës së Planit të Menaxhimit të Aseteve, vërehet se KRU-ja nuk ka arritur të bëjë planifikim të mira sipas prioriteteve të projekteve të investimeve kapitale.
8. Realizimi i investimeve në kanalizim është shumë i vogël në krahasim me të dhënat e aprovuara nga ARRU për vitin 2022.

6. Rekomandime

1. Projektet e aprovuara nga ARRU, dhe të mos realizuara nga KRU, duhet të realizohen në vitet pasuese të procesit tarifar 2022-2024.
2. Me rastin e mos realizimit të investimeve kapitale, gjatë viteve vijuese, në procesin e ardhshëm tarifar 2025-2027, ARRU do të ndërmerr veprime rregulluese sipas Rregullores Nr.12/2020 për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit në Kosovë.
3. KRU, të dorëzojë në ARRU, deri më 30 nëntor 2023, listën e azhurnuar të investimeve kapitale për vitet 2023 dhe 2024 sipas rregullimeve të bëra nga ARRU në procesin tarifar 2022-2024.
4. KRU, të jetë e vëmendshme që për shkaqe të procedurave të prokurimit, problemeve financiare, ndërrimeve të fundit të menaxhmentit, që të angazhohet, që këto të mos ndikojnë në mos realizimin e investimeve kapitale.
5. KRU, të angazhohet më shumë në finalizimin e Planit të Menaxhimit të Aseteve, më së largu deri me 31 tetor 2023.

6. KRU, të ketë koordinim më të mirë me Komunën dhe Donatorët e tjerë në mënyrë që planifikimet të bëhen me kohë dhe sipas prioriteteve dhe të përfshihen saktë në aplikacionin tarifor.
7. KRU, të bëj planifikim të saktë sipas nevojave prioritare, që shpijnë kah efienca më e mirë dhe zvogëlimi i humbjeve të ujit.
8. Emërtimi i projekteve të investimeve kapitale në BPRR të mos jetë i përgjithësuar por të jetë konciz e specifik dhe lehtë i monitorueshëm nga ARRU dhe palët tjera të interesit.

*Ky raport u punua nga:
Departamenti i Tarifave të ARRU
Gusht 2023*